VENDIM
Nr.68, datë 28.7.2005
PËR MIRATIMIN E RREGULLORE "PËR MBIKËQYRJEN E KONSOLIDUAR"

Neni 1
Baza ligjore

Baza ligjore e kësaj rregulloreje është ligji nr.8365, datë 2.7.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

Neni 2
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë të gjitha subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë, të cilat për thjeshtësi dhe në vazhdim do të quhen "shoqëri", që kanë në pronësi filiale dhe/ose pjesëmarrje në shoqëri të tjera të licencuara ose jo nga Banka e Shqipërisë, brenda dhe/ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 3
Qëllimi i mbikëqyrjes së konsoliduar

Mbikëqyrja e konsoliduar vlerëson pozicionin ndaj rrezikut/rreziqeve jo vetëm të veprimtarisë së vet shoqërisë, por edhe të veprimtarisë së filialeve dhe të pjesëmarrjeve të saj.

Neni 4
Përcaktime

Për plotësimin e kërkesave të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë kuptimin që vijon:

1. Shoqëria konsoliduese dhe/ose shoqëria – mëmë quhet subjekti që ka në pronësi filiale dhe pjesëmarrje në shoqëritë e tjera.
2. Shoqëri të konsoliduara quhen filialet dhe pjesëmarrjet e shoqërisë konsoliduese.
3. Grupi i konsoliduar përbëhet nga shoqëria konsoliduese dhe shoqëritë e konsoliduara.
4. Filiali ka të njëjtin kuptim me nenin 2 pika 1 germa g të ligjit nr.8365, datë 2.7.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", sipas të cilit ky term "nënkupton çdo person juridik në të cilin një subjekt tjetër ose persona juridikë të lidhur, zotërojnë më shumë se pesëdhjetë për qind të kapitalit ose të aksioneve me të drejtë vote, duke e lejuar këtë subjekt ose personat juridikë të lidhur të ushtrojnë kontroll mbi të".
5. Pjesëmarrje ka të njëtin kuptim me nenin 2 pika 1 germa ë të ligjit nr.8365, datë 2.7.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", sipas të cilit ky term "nënkupton zotërimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të së drejtës së pronësisë së një aksionari në masën dhjetë për qind ose më shumë të kapitalit të personit juridik ose të aksioneve të tij me të drejtë vote, ose në një masë të tillë që krijon mundësi të ndikojë në drejtimin dhe politikat e personit juridik".

Neni 5
Struktura e mbikëqyrjes së konsoliduar

Mbikëqyrja e konsoliduar përbëhet nga :

1. Kontabiliteti i konsoliduar,
2. Mbikëqyrja sasiore,
3. Mbikëqyrja cilësore.

Neni 6
Kontabiliteti i konsoliduar

1. Qëllimi i kontabilitetit të konsoliduar është pasqyrimi i gjendjes financiare të grupit të konsoliduar.

2. Organizimi i kontabilitetit të konsoliduar bëhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IAS 27, 28, 30, 31, 32, 39) dhe të Manualit të Kontabilitetit Bankar.

Neni 7

Mbikëqyrja sasiore

Mbikëqyrja sasiore është respektimi i kuadrit rregullator të mbikëqyrjes së konsoliduar, i cili përbëhet nga:

1. Kapitali rregullator në përputhje me udhëzimin "Për kapitalin rregullator", formulari i të cilit, për qëllime të mbikëqyrjes së konsoliduar, zëvendësohet me formularin bashkëngjitur.

2. Mjaftueshmëria e kapitalit sipas rregullores "Për mjaftueshmërinë e kapitalit".

3. Shpërndarja e rrezikut sipas rregullores "Për kontrollin e rreziqeve të mëdha".

4. Marrëdhëniet me personat e lidhur sipas rregullores "Për marrëdhëniet e bankës me personat e lidhur me të".

5. Mbulimi i rreziqeve të tregut sipas rregullores "Për rreziqet e tregut".

Neni 8

Mbikëqyrja cilësore

Mbikëqyrja cilësore përqendrohet në analizën e cilësisë mbi baza të konsoliduara, kryesisht të:

1. Organizimit të kontrollit të brendshëm dhe drejtimit të rrezikut/rreziqeve.

2. Strukturës drejtuese dhe strukturës organizative.

3. Vlerësimit të rrezikut operacional, strategjik, reputacional dhe ligjor.

4. Vlerësimit të rrezikut sistemik në perspektivë.

5. Strategjisë së veprimtarive të brendshme ndërmjet shoqërisë konsoliduese dhe shoqërive të konsoliduara.

6. Mjaftueshmërisë së informacionit.

7. Vlerësimit të drejtimit sipas politikave të brendshme dhe zbatueshmërisë së tyre në praktikë.

Neni 9

Bashkëpunimi në kuadër të mbikëqyrjes së konsoliduar

1. Ritja e cilësisë së mbikëqyrjes së konsoliduar realizohet duke lidhur marrëveshje reciproke bashkëpunimi ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe autoriteteve mbikëqyrëse dhe rregullative të njësive përbërëse të grupit të konsoliduar, brenda dhe jashtë vendit.

2. Banka e Shqipërisë ka të drejtë t'u kërkojë dhe t'u dërgojë raporte, të dhëna dhe informacion, autoriteteve mbikëqyrëse të vendeve të tjera, nëse ato janë të nevojshme për mbikëqyrjen e konsoliduar mbështetur në marrëveshje bashkëpunimi dhe mirëkuptimi, të nënshkruara midis palëve.

3. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të kryejë inspektime në vend dhe/ose të marrë informacion në kuadër të bashkëpunimit për mbikëqyrjen e konsoliduar, për të kontrolluar vërtetësinë e raporteve dhe të të dhënave për mbikëqyrjen e konsoliduar.

Neni 10

Raportimi

1. Shoqëritë konsoliduese përgatisin dhe vërtetojnë pranë auditorëve të jashtëm pasqyrat financiare të konsoliduara. Këto pasqyra raportohen në Bankën e Shqipërisë brenda afateve ligjore, në fund të çdo viti financiar.

2. Shoqëritë përgatisin raportet vjetore të publikueshme mbi baza të konsoliduara (grupit të konsoliduar).

3. Në raportet vjetore të publikueshme, shoqëritë publikojnë listën e filialeve dhe të pjesëmarrjeve, të cilat janë përfshirë në pasqyrat e konsoliduara. Gjithashtu, në raportet vjetore përfshihet edhe lista e pjesëmarrjeve të cilat nuk janë konsoliduar, e shoqëruar me shënimet përkatëse.

4. Në zbatim të nenit 7 të kësaj rregulloreje, raportimet bëhen sipas përcaktimeve në aktet rregullative përkatëse.

5. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të kërkojë informacion shtesë për shoqëritë konsoliduese dhe/ose të konsoliduara.

Neni 11

Dispozitë përfundimtare

Kjo rregullore është miratuar me vendimin nr.68, datë 28.7.2005 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Ardian Fullani

FORMULARI I RAPORTIMIT
(kapitali rregullator për mbulimin e rreziqeve të kredisë)

Emri i grupit bankar të konsoliduar ....
Periudha raportuese .....
Data e raportimit .....
Përgatiti (Emër,mbiemër,firmë)
Drejtuesi (Emër,mbiemër,firmë)

në mijë Lekë.

	KAPITALI BAZË	Nr.llog.		Shuma
	I . Elementet përbërëse që shtohen (A) :			
1	Kapitali i nënshkruar	5711		
2	Rezervat (përveç rezervave të rivlerësimit)	5731,5733,5734		
3	Primet e emetimit dhe të fuzionimit	572		
4	Fitimet e pashpërndara (e bartura)	577(P)		
5	Fitimi ushtrimor i fundit të vitit	578(P)		
6	Fitimi ushtrimor i periudhës raportuese	578(P)		
7	Diferenca rivlerësimi kreditore (pozitive)	574(P)		
8	Diferencat e konsolidimit kreditore (pozitive)			
9	Interesat pjesëmarrës të pakicës			
	Nëntotali A= (1+2+3+4+5+6+7+8+9)		A	
	II . Elementet përbërëse që zbriten (B) :			
1	Kapitali i nënshkruar i papaguar	5712		
2	Vlera nominale e aksioneve (të pashitura , të riblera)			
3	Humbjet e pashpërndara (të bartura)	577(-P)		
4	Humbja ushtrimore	578(-P)		
5	Diferenca rivlerësimi debitore (negative)	574(-P)		

6	Aktive1 të qëndrueshme të patrupëzuara	531		
7	Diferencat e konsolidimit debitore (negative)			
	Nëntotali B= (1+2+3+4+5+6+7)		B	
	Totali i kapitalit bazë C= (A-B)		C	
	KAPITALI SHTESË			
	III . Elementet përbërëse (J) :			
1	Rezervat e rivlerësimit	5732	EA	
2	Rezerva të përgjithshme		EB	
3	Istrumente hibride	56	EC	
4	Detyrime të varura me afat	56	F	
	Në qoftë se F < = C/2 atëherë G = F		G	
	Në qoftë se F > C/2 atëherë G = C/2		G	
	Nëntotali i kufizuar H = (EA + EB + EC + G) :		H	
	Kufizimi i parë: në qoftë se H < = C atëherë J = H		J	
	Kufizimi i dytë: në qoftë se H > C atëherë J = C		J	
	Totali i kapitalit shtesë para zbritjes (J)		J	
	IV . Elementet përbërëse që zbriten (P +Q+V) :			
1	Interesat pjesëmarrëse (P):			
--	Në shoqëritë jofinanciare të konsoliduara sipas metodës së kapitalit.		K	
--	Në shoqëritë financiare dhe jofinanciare të përjashtuara nga perimetri i konsolidimit.		L	
	Nëntotali P = (K+N)		P	
2	Garancitë e dhëna fondeve të garancive reciproke sipas kushteve të bankës qendrore.		Q	
3	Aktet rregullative të Bankës së Shqipërisë (V) :			
--	rregullorja "Për administrimin e rrezikut të kredisë", miratuar me vendimin nr.13, datë 21.02.01 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë;		V1	
--	rregullorja "Për madhësinë dhe plotësimin e kapitalit fillestar minimal për veprimtaritë e lejuara të bankave dhe të degëve të bankave të huaja të licencuara", miratuar me vendimin nr.51, datë 22.04.99 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë;		V2	
--	akte të tjera rregullative.		Vn	
	totali i akteve rregullative : V= (V1+V2+Vn)		V	
	Nëntotali i pjesës që zbritet është (P+Q+V)		P+Q+V	
	Llogaritja përmbledhëse e kapitalit bazë dhe e kapitalit shtesë pas zbritjes IV :			
1	Në qoftë se J < = (P+Q+V) atëherë :			
--	Kapitali shtesë pas zbritjes JA = 0		JA	
--	Kapitali bazë CA= C + J- (P+Q+V)		CA	
2	Në qoftë se J > (P+Q) atëherë :			
--	Kapitali shtesë pas zbritjes JA = J- (P+Q+V)		JA	

[1] sipas Manualit të Kontabilitetit Bankar duhet të zëvendësohet me fjalën "mjete".

--	Kapitali bazë CA= C		CA	
	Totali i kapitalit bazë dhe i kapitalit shtesë : E= (JA+CA)		E	